

Gjykatës Themelore në Pejë  
Dega në Deçan  
Departamenti i Përgjithshëm

<b>Paditës</b>	<b>Kelkos Energy Sh.P.K.</b> , me numër unik identifikues 810796005 dhe me adresë në Rr. Deme Ali Pozhari nr. 41, 51000 Deçan, të përfaqësuar nga Avokati Arianit Koci, në vazhdim « <b>Paditësi</b> »
<b>I Paditur</b>	<b>Adriatik Gacaferi</b> nga Deçani, i përfaqësuar nga Avokatja Rina Kika sipas autorizimit të bashkëngjitur, në vazhdim « <b>i Padituri</b> »
<b>Vlera e kontestit</b>	EUR 10,000 (dhjetë mijë euro)
<b>Numri i lëndës</b>	Cnr. 42/2020
<b>Data</b>	23 korrik 2019

## PËRGJIGJE NË PADI

I Padituri ka pranuar Padinë për Shpifje më 9 korrik 2020 dhe këtë Përgjigje në Padi e parashtron brenda afatit ligjor dhe në përputhje me Aktvendimin Nr. 01002475, të datës 02 korrik 2020 të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega Deçan (në vazhdim «**Gjykata**»). I Padituri e kundërshton kërkesëpadinë e Paditësit përmes kësaj përgjigje në padi sipas argumenteve dhe provave të bashkëngjitura.

### **Baza faktike**

1. I Padituri është qytetar i Deçanit, bjeshkatar dhe për më shumë se një dekadë është përfshirë, në kapacitetin e tij personal, në çështje që lidhen me mbrojtjen e ambientit në Kosovë. Ai angazhohet për zhvillimin e turizmit malor në Kosovë, punon si udhërrëfyes malor dhe organizon ekskursione për turistë të huaj e për vendorë nëpër malet e Kosovës, të Shqipërisë dhe të Malit të Zi.
2. Më **1 nëntor 2019**, i Padituri, në llogarinë e tij të rrjetit social Facebook, kishte publikuar një postim me një fotografi dhe tekstin me përmbajtjen si vijon:

«**Hidrocentrali Lumbardhi 2 ne Gryken e Deçanit, sot rreth ores 14:30 duke e futur 100% te ujit ne gypa edhe pse ne marrveshjen qe**

**ka me Ministrine e Mjedisit eshte i obliguar qe te pakten 30% te ujit ta le gjithmone ne shtratin e lumit.**

**Sikur te kishet pasur nje gjykate qe do i mbronte kafshet e egera dhe peshqit, Kelkos Energy (pronari e HEC) do ishte denuar per gjenocid ndaj kafsheve dhe peshqiv.»**

3. Në këtë postim publik, i Padituri i kishte etiketuar (tag) tri institucione dhe një ministër: Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor , Zyrën e Rregullatorit për Energji, Komunën e Deçanit, dhe (tani ish-) Ministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Z. Fatmir Z. Matoshi. Në fotografinë e bashkëngjitur në postimin në Facebook, shihet se si rrjedha e lumit pengohet nga presa dhe rezervari/akumuluesi i ujit të Hidrocentralit Lumbardhi 2, dhe vërehet se si pjesa jashta saj është krejt e thatë dhe pa ujë.

4. Më **3 nëntor 2019**, RTK kishte publikuar një shkrim të titulluar **«Kush po dëshiron ikjen e investitorëve të huaj – Rojet e vetëshpallura të mjedisit bëhen gjithnjë e më popullore këto ditë.»**. Ky shkrim as që është më i qasshëm online në faqen e RTK-së. Paditësi e ka bashkëngjitur një përkthim jo-zyrtar të këtij shkrimi në gjuhën angleze si Prova nr.4. Kjo «provë» në fakt nuk vërteton asgjë, siç do të elaborohet në vijim.

5. Më **4 nëntor 2019**, i Padituri kishte publikuar një postim të ri në Facebook si kundërpërgjigje sqaruese ndaj shkrimit të RTK-së për postimin e tij të datës 1 nëntor 2019. Në këtë postim ai e kishte bashkëngjitur madje edhe një hartë me spjegime teknike të procesit të rrjedhës së ujit në gyp: «(...) uji futet në gypa te presa që ndodhet te Hidrocentrali Lumbardhi 2 (ku është bërë foto) e pastaj pas 3km (siç e tregon foto2) dhe rreth 250m ramje lartesisie shkon tek gjeneratori i Lumbardhit 1 për të krijuar energji. (...)».

**Prova nr.1:** Postim në Facebook në llogarinë private të të Paditurit, Adriatik Gacaferi, 4 nëntor 2020.

6. Më **4 nëntor 2019**, organizata jo-qeveritare GAIA Kosovo ka parashtruar ankesë në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës («**KMSHK**») ndaj RTKlive.com dhe Periskopit, për shkrimin me titull: **«Kush po dëshiron ikjen e investitorëve të huaj – Rojet e vetëshpallura të mjedisit bëhen gjithnjë e më popullore këto ditë.»** Në Ankesë, GAIA kishte argumentuar se shkrimi përmban shkelje të Kreut II Kodit të Mediave që përcakton etikën e raportimit të së vërtetës. Mes tjerash në Ankesë theksohet se: (1) artikulli përmban të pavërteta; (2) nuk e ka burimin e informatës të identifikueshëm; (3) e komenton një deklaratë dhe një fotografi pa e postuar deklaratën për të cilën bëhet fjalë (4) teksti është i shkruar në vetën e parë dhe nuk është i nënshkruar. Më **20 dhjetor 2019**, KSHMK ka nxjerrë Vendim me numër të referencës

04.11.2019\877-2019 dhe e ka vlerësuar Ankesën e GAIA-s si të bazuar. Në vendim theksohet se Ankuesi e ka vlerësuar drejtë se shkrimi i publikuar nuk i plotëson standardet e raportimit të së vërtetës sipas Kodit të Mediave. Po ashtu, konstaton se RTKlive.com e ka hequr këtë shkrim nga portali i saj. Megjithatë, kjo nuk e ka penguar Paditësin që të përpiqet ta vë në lajtim gjykatën duke e paraqitur si provë në këtë proces gjyqësor.

**Prova nr.2.1:** Vendimi Ref: 04.11.2019\877-2019, i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, i datës 20 dhjetor 2019.

**Prova nr.2.2:** Ankesë në KSHMK e parashtruar më 4 nëntor 2019 nga GAIA Kosova kundër RTKlive.com dhe Periskopit, për shkrimin me titull: «**Kush po dëshiron ikjen e investitorëve të huaj – Rojet e vetëshpallura të mjedisit bëhen gjithnjë e më popullore këto ditë.**»

7. Më **31 janar 2020**, për shkak të këtij postimi në Facebook, Paditësi e ka paditur për shpifje të Paditurin, dhe ka kërkuar nga ai kompensim për dëm të reputacionit në vlerë prej 10,000 euro (dhjetë mijë euro).

### **Baza juridike**

8. Paditësi, pretendon se postimi në Facebook i të Paditurit i datës 1 nëntor 2019 përbën shpifje dhe se i ka shkaktuar dëm reputacionit të tij. Sa i përket pretendimeve të padisë, më poshtë janë trajtuar ndaras: **A.** argumentet për sa i përket pretendimeve të paditësit për shpifje dhe **B.** argumentet për sa i përket pretendimeve të Paditësit për dëmin e reputacionit.

9. Së pari, është e rëndësishme të konstatohet se deklarata e të Paditurit është deklaratë për çështje me interes publik. Sipas nenit 3, paragrafi k të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes, çështje e interesit publik është çdo çështje që është në interes të publikut të publikohet duke përfshirë këtu **çështjet që kanë të bëjnë me ambientin**. I Padituri ka shkruar në Facebook lidhur me mbrojtjen e Lumbardhit në Grykën e Deçanit dhe dëmin që po i shkaktohet faunës në këtë zonë. Madje, faktin se deklarata e të Paditurit është çështje me interes publik e ka pranuar edhe vet Paditësi gjatë paraqitjes së pretendimeve në paragrafin 1.7 të Padi-së. Prandaj kërkojmë nga Gjykata që deklaratën e plotë të të Paditurit ta trajtojë si deklaratë për çështje me interes publik gjatë shqyrtimit të kësaj padie.

## A. Sa i përket pretendimeve për shpifje

10. Padiësi, pretendon se postimi në Facebook i të Paditurit i datës 1 nëntor 2019 përbën shpifje mirëpo, deklarata e të Paditurit gëzon mbrojtje brenda të drejtës së lirisë së shprehjes si e drejtë fundamentale njerëzore e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës së Kosovës. Siç është elaboruar më poshtë, pjesa e parë e deklaratës së të Paditurit që ka të bëjë me futjen e 100% të ujit të Lumbardhit në gyp, gëzon mbrojtje si **deklaratë për një çështje me interes publik** dhe si **publikim i arsyeshem** në bazë të nenit 5, paragrafi 3 dhe nenit 7 të Ligjit Nr.02/L-65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes («**Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes**»). Ndërkaq, pjesa e dytë e deklaratës së të Paditurit, që ka të bëjë me mendimin se Padiësi do të duhej të dënohej për «gjenocid» ndaj kafshëve dhe peshqve, gëzon mbrojtje si **shprehje e opinionit** në bazë të nenit 8 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Për zbërthimin e argumenteve të mbrojtjes ligjore që e gëzon deklarata e të Paditurit do të shqyrtohen ndaras dy fjalitë e postimit në Facebook.

*i. Sa i përket pretendimit për shpifje të pjesa e deklaratës për futjen e 100% të ujit në gyp dhe detyrimin të lënies së 30% të ujit të lumit përberë në shtratin e tij*

11. I Padituri ka vëzhguar se si presa dhe rezervari/akumuluesi i ujit të Hidrocentralit Lumbardhi 2 po e pengon rrjedhën e ujit e ka lënë të thatë shtratin e lumit. I Padituri krahas tekstit të postimit të tij në Facebook ka publikuar edhe një fotografi ku shihet pengimi i rrjedhës dhe pjesa e shtratit të Lumbardhit krejtësisht e thatë. Në fjalinë e parë të postimit, fotografisë të bashkëngjitur si Prova Nr.1, i Padituri ia bën këtë përshkrim:

**«Hidrocentrali Lumbardhi 2 në Gryken e Deçanit, sot rreth  
ores 14:30 duke e futur 100% të ujit në gypa edhe pse në  
marrveshjen që ka me Ministrinë e Mjedisit është i obliguar  
që të pakten 30% të ujit ta le gjithmonë në shtratin e lumit.**

12. Sipas Padiësit, kjo deklaratë është deklaratë shpifëse, ose deklaratë të cilën i Padituri e ka ditur ose është dashur ta dijë se është e pavërtetë me arsyetimin se: (1) nuk është futur 100% e ujit të lumit në gypa të Padiësit në ditën kur i Padituri e ka bërë fotografinë; (2) se Padiësi nuk e ka për obligim që 30% të ujit ta le gjithmonë në shtratin e lumit; dhe (3) marrëveshja e Padiësit ku përcaktohet ky detyrim është vetëm «pretendim» i Padiësit. Kontestimin e këtyre deklaratave Padiësi e mbështet në supozimin se kinse i Padituri deklaratën e tij e ka mbështetur **vetëm** në fotografinë e postuar. Të gjitha këto pretendime e të Padiësit janë të pabazuara.

13. Detyrimi i Padiësit për lënien e 30% të ujit në shtratin e lumit, si respektim i standardit të minimumit ekologjik dhe ekzistimi i një marrëveshjeje ku ky është një ndër detyrimet e përcaktuara **është informatë publike**. Këtë e ka konfirmuar ish-Kryetari i Komunës së Deçanit, Rasim

Selmanaj për portalin e lajmeve online Telegrafi.com më 22 qershor 2016. Në artikullin e titulluar «Komuna e Deçanit padit kompaninë austriake, shkeli ligjin me hidrocentralet», theksohet si vijon:

**«Kryetari i Deçanit, Rasim Selmanaj ka thënë për Telegrafin se investitori nuk po i respekton lejet përkatëse të lëshuara nga MMPH-ja dhe kontratën në të cilën shkruan qartë se asnjëherë nuk guxon të mbetet nën 30 për qind të ujit në lum.»**

14. Sipas artikullit në fjalë, Komuna e Deçanit ka inicuar më 22 qershor 2016 padi përmes Policisë së Kosovës dhe se do t'i përdorin të gjitha mjetet ligjore **për shkak të mos-respektimit të kontratës dhe obligimeve që dalin nga kontrata nga ana e Paditësit.**

15. Më 10 mars 2019, Kryetari i tanishëm i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj e ka konfirmuar për portalin online të lajmeve Koha.net ekzistimin e kontestit në mes të Komunës së Deçanit dhe Paditësit për shkak të mosrespektimit të minimumit ekologjik gjatë shfrytëzimit të ujit për prodhim të energjisë elektrike. Ramosaj, mos-respektimin e minimumit ekologjik e cilëson si shkeljen kryesore të Paditësit gjatë ndërtimit të hidrocentraleve, dhe këtë e cilëson si detyrim që rrjedhë nga «marrëveshja dhe kontrata». Kryetari Ramosaj po ashtu është cituar nga Koha.net të ketë thënë: **«Kompania ndërtuese është austriake dhe këtë veprim po ta kishte bërë në Austri ai kishte përfunduar në burg, këtë e them me bindje të plotë pasi së paku ka bërë dy tri shkelje».**

16. Sipas nenit 5, paragrafi 1 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes personat mund të japin përgjegjësi për shpifje për çështje të interesit publik **vetëm** në qoftë se autori e ka ditur se informacioni ka qenë i rrejshëm ose ka vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e tij. Në rastin konkret, i Padituri ka pasur informata nga dy zyrtarë publikë të lartë: dy kryetarë të komunës së Deçanit, të cilët gjatë mandatit të tyre si kryetarë kanë deklaruar publikisht se ekziston një marrëveshje për hidrocentralet e ndërtuara në Lumbardh të Grykës së Deçanit, dhe se një ndër detyrimet e Paditësit sipas marrëveshjes është respektimi i minimumit ekologjik, që është lënja e 30% të ujit të lumit në shtratin e tij. Të dy kryetarët e komunës së Deçanit kanë deklaruar publikisht se Paditësi e ka shkelur këtë obligim të dalë nga marrëveshja, në të cilën përcaktohet si kusht thelbësor respektimi i minimumit ekologjik 30%. Paditësi, si aktivist i ambientit, ka qenë i njoftuar lidhur me këto deklarata të zyrtarëve publikë kompetentë dhe mbi këto informata të qasshme publikisht e ka mbështetur deklarin e tij se Paditësi sipas marrëveshjes se **«është i obliguar që të paktën 30% të ujit ta lë gjithmonë në shtratin e lumit.»** Prandaj, pretendimet për shpifje të Paditësit janë të pabazuara sepse informacioni i shpërndarë nga Paditësi ka qenë i bazuar në informata që janë publikuar nga zyrtarë publikë për ekzistimin e një marrëveshje për hidrocentrale

dhe për ekzistimin e detyrimit të Paditësit për respektimin e minimumit ekologjik 30%. Madje edhe shkelja e këtij obligimi nga Paditësi është informatë publike.

**Prova nr.3:** Telegrafi.com, [«Komuna e Deçanit padit kompaninë austriake, shkeli ligjin me hidrocentrale»](#), 22 qershor 2016.

**Prova nr.4.** Koha.net, [«Ramosaj thotë se kompania austriake bëri shumë shkelje kur nisi ndërtimin e hidrocentraleve në Lumbardh»](#), 10 mars 2019.

17. Pretendimet për shpifje, Paditësi i mbështetë në një pretendim të vetëm: në ditën kur i Padituri e ka publikuar postimin, Hidrocentrali Lumbardhi 2 ka qenë jashtë funksionit dhe se nuk ka prodhuar rrymë. Të gjitha dokumentet e bashkëngjitura nga Paditësi (me përjashtim të shkrimit të RTKlive.com që KMSHK ka konstatuar se nuk i përmbushë standardet e etikës së gazetareve për raportimin e të vërtetës) i janë prezantuar Gjykatës për të mbështetur pretendimin se Hidrocentrali Lumbardhi 2 ka qenë jashtë funksionit dhe nuk ka prodhuar rrymë në ditën kur i Padituri e ka bërë fotografinë. Të gjitha këto argumente dhe prova janë të parëndësishme në shqyrtimin e kësaj padie, pasi që i Padituri në postimin e tij në Facebook nuk ka deklaruar se Lumbardhi 2 ka qenë duke prodhuar rrymë. Deklarata e të Paditurit është i qartë: në fotografinë e paraqitur shihet se si gypi i ujit të Hidrocentralit Lumbardhi 2 në Grykën e Deçanit ka futur 100% e ujit, në kundërshtim me kushtin që 30% e ujit të lihet gjithmonë në shtratin e ujit. Futja e 100% e ujit në gypin e dytë ka qenë e dukshme për të Paditurin. Nuk mund të pritët nga i Padituri që të verifikojë nëse ka qenë duke prodhuar rrymë Paditësi në momentin kur e ka vëzhguar se uji po pengohet nga presja e Hidrocentralit Lumbardhi 2 dhe se shtrati i lumit ka mbetur pa ujë. Po ashtu, i Padituri kishte publikuar postimin e dytë në Facebook (i bashkëngjitur si Prova nr.1) si sqarim për postimin e tij të datës 1 nëntor 2019. Në këtë postim ai e kishte bashkëngjitur madje edhe një hartë me spjegime teknike të procesit të rrjedhës së ujit në gyp: «(...) uji futet në gypa te presa që ndodhet te Hidrocentrali Lumbardhi 2 (ku është bërë foto) e pastaj pas 3km (siç e tregon foto2) dhe rreth 250m ramje lartësie shkon tek gjeneratori i Lumbardhit 1 për të krijuar energji. (...)».

18. Përveç kësaj, deklarimi i të Paditurit lidhur me futjen e 100% të ujit në gypa gëzon mbrojtje si publikim i arsyeshëm për çështje me interes publik. Sipas nenit 7 të Ligjit për Shpifje dhe Fyerje përcaktohet se askush nuk do të mbajë përgjegjësi për shpifje për deklarata lidhur me çështje me interes publik kur është e arsyeshme në të gjitha rrethanat që një person në pozitën e tyre të përhapte materialin me qëllim të mirë për informimin e publikut në kohë. I Padituri është aktivist që angazhohet për mbrojtjen e ambientit dhe ka postuar një deklaram publik, ku i ka etiketuar tri

institucione dhe një ministër: Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Zyrën e Rregullatorit për Energji, Komunën e Deçanit, dhe (tani ish-) Ministrin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Z. Fatmir Z. Matoshi. Qëllimi i publikimit të deklaratës së tij në Facebook ishte që në njërin anë ta njoftojë e ta alarmojë publikun për mbrojtjen e Lumbardhit, dhe në anën tjetër t'u bëjë apel institucioneve përkatëse që të ndër marrin veprime për të parandaluar dhe evituar dëmet ndaj Lumbardhit. Rrjedhimisht, deklarimi i Paditësit është publikim i arsyeshëm sipas nenit 7 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes, meqë si aktivist për mbrojtjen e ambientit, publikimi i deklaramit dhe fotografisë ka ndjekur një qëllim të mirë për njoftimin e publikut në kohë për një çështje me interes publik.

19. Si përfundim, deklarata e të Paditurit gëzon mbrojtje si deklaratë e shprehur për një çështje me interes publik për të cilën ai nuk mund të mbahet përgjegjës për shpifje për shkak se: e ka mbështetur deklaratën e tij për kalimin e 100% të ujit në gypa me vëzhgimin e vendit ku e ka bërë fotografinë. Këtë vëzhgim e ka dokumentuar me fotografi. Ndërkaq, për detyrimin që Paditësi ta lë 30% të ujit të lumit në shtratin e tij sipas marrëveshjes për ndërtimin e hidrocentraleve, i Padituri është mbështetur në deklaratat publike të Kryetarëve të Komunës së Deçanit Selmanaj dhe Ramosaj. Për shkak të këtyre arsyeve, të gjitha pretendimet e Paditësit se Paditësi ka shpifur janë të pabazuara dhe duhet të refuzohen si të tilla nga Gjykata.

*ii. Sa i përket pretendimit për shpifje të pjesës së postimit për «gjenocid» ndaj kafshëve dhe peshqve*

20. Në fjalinë e dytë të postimit në Facebook, i Padituri është shprehur si vijon:

**«Sikur te kishet pasur nje gjykate qe do i mbronte kafshet e egra dhe peshqit, Kelkos Energy (pronari e HEC) do ishte denuar per gjenocid ndaj kafsheve dhe peshqve.»**

21. Sipas Paditësit, kjo deklaratë e të Paditurit është e pavërtetë dhe është paragjykim skajshmërisht i pabazuar që përmban shprehje nënçmuese. Në lidhje me të drejtën e lirisë së shprehjes një ndër parimet themelore të vendosura nga GJEDNJ qysh në vitin 1976 në rastin *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, e që përmendet në pothuajse të gjitha vendimet e kësaj gjykate për raste të lirisë së shprehjes për çështje të interesit publik, thekson:

«Liria e shprehjes është një ndër themelet qenësore të një shoqërie demokratike dhe një ndër kushtet bazike për zhvillimin e saj dhe për vetëpërmbushjen e secilit individ. Paragrafit 2 të nenit 10, **nuk i nënshtrohen vetëm ‘informatat’ apo ‘idetë’ që pranohen e pëlqehen apo që shihen si jo-ofenduese a si çështje indiferente, por edhe ato që ofendojnë, shokojnë dhe shqetësojnë. Të tilla**

**janë kërkesat për pluralizëm, tolerancë dhe mendjegjerësi pa të cilat nuk ka 'shoqëri demokratike'».<sup>1</sup>**

Siç parashihet në nenin 10, e drejta e lirisë së shprehjes i nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhet të interpretohen ngushtë, dhe nevoja për kufizime duhet të konstatohet bindshëm.

22. Deklarimi i të Paditurit se po të kishte pasur një gjykatë që do t'i mbronte kafshët e egera dhe peshqit, Paditësi do të ishte dënuar për «gjenocid» ndaj kafsheve dhe peshqve, është deklarim i mbrojtur si opinion brenda lirisë së shprehjes. Është e qartë se ky mendim ose kjo ide e të Paditurit e ka bërë Paditësin të ndihet i nënçmuar. Sidoqoftë, ky nuk është argument që e mbështetë pretendimin e Paditësit për shpifje pasi që brenda lirisë së shprehjes mbrohen edhe idetë që ofendojnë, shokojnë e shqetësojnë - siç është rasti edhe me opinionin e shprehur të të Paditurit.

23. Krahas kësaj, sipas nenit 8 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes, askush nuk mund të mbahet përgjegjës për shpifje për një deklaratë të cilën gjykata e vlerëson si deklaram të opinionit, me kusht që opinionin të jetë shprehur me qëllim të mirë dhe të jetë bazuar në ndonjë fakt. Edhe në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së njihet dallimi në mes të deklarimeve të fakteve dhe opinionëve apo shprehjes së bindjeve. Sipas praktikës së zhvilluar nga GjEDNj në vendimin *Steel dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përderisa ekzistimi i fakteve mund të demonstron, e vërteta në opinionë/shprehje të bindjeve nuk mund t'i nënshtrohet vërtetimit.<sup>2</sup> Për opinionë duhet të ekzistojë bazë faktike e mjaftueshme për ta mbështetur opinionin, por nuk mund të kërkohe vërtetimi i tij.<sup>3</sup>

24. Qëllimi i publikimit të deklaratës së të Paditurit në Facebook ishte që në njërin anë të njoftohet dhe të alarmohet publiku për mbrojtjen e Lumbardhit, dhe në anën tjetër t'u bëjë apel institucioneve përkatëse që të ndërmarin veprime për të parandaluar dhe evituar dëmet ndaj Lumbardhit të Deçanit. Sa i përket kushtit që opinionin të jetë i bazuar në ndonjë fakt, i Padituri, si aktivist për mbrojtjen e ambientit ka përcjellë raportimet e institucioneve, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile për operimin dhe dëmin e shkaktuar nga Paditësi ndaj Grykës së Deçanit.

---

<sup>1</sup> GjEDNj, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 49. Teksti original në gjuhën angleze është si vijon: «Freedom of expression constitutes one of the essential foundations of such a society, one of the basic conditions for its progress and for the development of every man. Subject to paragraph 2 of Article 10 (art. 10-2), it is applicable not only to "information" or "ideas" that are favourably received or regarded as inoffensive or as a matter of indifference, but also to those that offend, shock or disturb the State or any sector of the population. Such are the demands of that pluralism, tolerance and broadmindedness without which there is no "democratic society". This means, amongst other things, that every "formality", "condition", "restriction" or "penalty" imposed in this sphere must be proportionate to the legitimate aim pursued.»

<sup>2</sup> GjEDNj, *Steel dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 87 dhe referencat në të.

<sup>3</sup> Po aty.



Opinionin për një gjykatë që i mbron kafshët e egra dhe peshqit duke i dënuar ata që po i shkaktojnë dëm, është i mbështetur në raportime nga institucionet, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile. Raportimet mbi të cilat e ka formësuar opinionin i Padituri paraqesin bazë faktike të mjaftueshme për të gëzuar mbrojtje brenda lirisë së shprehjes si opinion. Meqë janë të shumta, në këtë përgjigje në padi po i përfshijmë vetëm disa nga to.

25. Siç u përmend më sipër, dy deklaratimet zyrtare publike për mediat që i kanë dhënë kryetarët e Komunës së Deçanit, Rasim Selmanaj (2016) dhe Bashkim Ramosaj (2019), të bashkëngjitura këtu si Provat nr.3 dhe 4, tregojnë për qëndrimet zyrtare të Komunës së Deçanit se ka pasur shkelje të ligjit dhe dëm ndaj mjedisit që e ka shkaktuar Paditësi me ndërtimin e hidrocentraleve dhe shpërfilljen e detyrimeve kontraktuale. Shkeljet ligjore të Paditësit me operimin e Hidrocentraleve të ndërtuara në Grykën e Deçanit është konstatuar edhe nga Zyra e Rregullatorit për Energji («ZRRE») më 14 dhjetor 2016. Në këtë Raport, ZRRE konstaton se **Paditësi pa e pasur licencën për operim nga ZRRE, e pa pasur leje mjedisore, ka vazhduar operimin e Hidrocentraleve të Deçanit dhe Bellajës.** Nga futja në operim të këtyre hidrocentraleve, Paditësi ka përfituar materialisht siç konstatohet nga ZRRE gjeneratorët e këtyre hidrocentraleve janë në operim komercial.<sup>4</sup> Ky është konstatimi i ZRRE-së:

«Nga futja në operim e HC Belaje dhe HC Deçan e deri me tash Kelkos ka operuar pa licencë. Fillimisht ky aktivitet është kryer si operim testues, por nga 01 prill 2016 gjeneratorët janë në operim komercial. Në shkurt 2016 Kelkos ka aplikuar për licencë, **por në pamundësi të marrjes së lejes mjedisore** nga MMPH (neni 31 “Leja Mjedisore” i Ligjit për mbrojtjen e mjedisit) **ZRRE nuk i ka lëshuar licencë për operim. Pavarësisht kësaj Kelkos ka vazhduar me operimin e HC Deçani dhe HC Belaje, pa licencë.»<sup>5</sup>**

26. Përpos këtyre, janë publikuar dhjetëra artikuj nga mediat në Kosovë që kanë raportuar për protestat e banorëve të Deçanit dhe organizatave të shoqërisë civile kundër hidrocentraleve të Paditësit si dhe për dëmet që i janë shkaktuar Grykës së Deçanit nga aktiviteti i Paditësit. Këtu po i bashkëngjesim vetëm disa nga to:

---

<sup>4</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, *Raport nga monitorimi i ndërmarrjes “Kelkos Energy” Sh.p.k.*, 14 dhjetor 2016, faqe 17-18.

<sup>5</sup> Po aty.

## Prova nr.5:

- 5.1. Kallxo.com, [Vuajtja e Grykës së Deçanit nga hidrocentralet](#), 13 shtator 2018.
  - 5.2. Koha.net, [Katër hidrocentrale si ato që po synohen në Lumbardh kanë shkatërruar Grykën e Deçanit](#), 25 shkurt 2019.
  - 5.3. RTKlive.com, [MMPH-ja dhe shoqëria civile kundër vendimit për tri hidrocentralet në Deçan](#), 15 tetor 2019
  - 5.4. RTV21.tv, Protestuesit ‘pushtojnë’ grykën e Deçanit kundër hidrocentraleve pa leje, 13 korrik 2019
  - 5.5. Kosovalive.org, Ndërtimi i hidrocentraleve të Deçanit po e lë pa ujë shtratin e Lumëbardhit, 29 qershor 2016
  - 5.6. Klan Kosova TV, [Hidrocentrali në Deçan thanë Zonën](#), 10 prill 2016.
27. Përpos raportimeve në media, Paditësi është kritikuar për dëmtimin e ambientit në Lumbardhin e Deçanit edhe nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile. Njëri nga to është Raporti i organizatave Balkan Green Foundation dhe INDEP, i publikuar në mars 2019 me titull «Hidrocentralet në Kosovë – Problemet dhe Potenciali i Tyre Reab», ku theksohet:

**«Investimet e fundit që kanë ndodhur në luginën e Lumbardhit të Deçanit nga kompania austriake Kelkos Energy kanë rezultuar me probleme të shumta mjedisore, me projekte gjysmake dhe të dështuara që i kanë vënë hije të keqe investimeve në sektorin e hidroenergjisë. Ky rast ka shtyrë Komunën e Deçanit të ndërmerre edhe hapa ligjor me kërcënim për të ngritur padi ndaj kompanisë në fjalë si dhe ndaj vetë MMPH-së për mos-respektim të minimumit biologjik.**

**Ndër hapësirat dhe bjeshkët më të bukura në Kosovë janë në rrezik të shkatërrimit të pakthyeshem nga ndërhyrja brutale me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike nga uji, në kuadër të shtimit të nivelit të energjisë së ripërtëritshme. “Banorë të qytetit të Deçanit janë alarmuar nga rritja shumë e shpejtë e projekteve zhvillimore që rrezikojnë lumenjtë dhe bjeshkët nga degradimi ambiental por dhe që kanë efekt direkt në jetën e popullatës atje.”**

Kështu, Komuna e Deçanit por edhe ajo e Pejës, kanë marrë qëndrim që të ndalojnë kategorikisht ndërtimet e reja të hidrocentraleve në Lumbardhin e Deçanit e atë të Pejës, **ku këto projekte shihen si degradim i natyrës dhe që pengojnë dukshëm zhvillimin e turizmit**

**dhe biejnë ndesh me planet dhe projektet komunale të zhvillimit e kanë ndikim negativ në turizëm.** Prej këtyre projekteve po përfitojnë kryesisht grupe të caktuara të interesit e jo Deçanasit apo qytetarët e Pejës dhe prandaj kanë vendosur që të mos lëshojnë leje ndërtimi për HCV apo të mëdha në ato hapësira, pavarësisht se institucionet tjera të nivelit qendror u kanë dhënë leje.»<sup>6</sup>

28. Më tej, në përfundimet e këtij raporti theksohet:

«Mungojnë mekanizmat efektiv të monitorimit të zbatimit të projekteve. Zyra e Rregullatorit për Energji, Inspektorati i Mjedisit dhe mekanizmat e tjerë kanë dështuar të sigurojnë se projektet respektojnë standardet mjedisore dhe obligimet ligjore që kanë. Në mungesë të mekanizmave mbikëqyrës, **kompanitë në shumë raste kanë abuzuar me licencat dhe nuk kanë respektuar kushtet e kontratave.** Kjo mungesë e inspektimeve dhe ndëshkimeve **ka rezultuar me zona të dëmtuara dhe aktivitete të paligjshme e rrjedhimisht kjo është shoqëruar edhe me probleme sociale.»<sup>7</sup>**

**Prova nr.6.1:** INDEP, Balkan Green Foundation, *Hidrocentralet në Kosovë – Problemet dhe potenciali i tyre real*, mars 2019, faqet 1-3, 18-20 dhe 24.

**Prova nr.6.2:** Zyra e Rregullatorit për Energji, *Raport nga monitorimi i ndërmarrjes “Kelkos Energy” Sh.p.k.*, 14 dhjetor 2016, faqet 1, 17 dhe 18.

29. Prandaj opinionioni i shprehur nga i Padituri për dënimin e Paditësit për «gjenocid» ndaj kafshëve të egra dhe peshqve, është deklaratë e mbrojtur brenda lirisë së shprehjes pasi që është opinion i shprehur për qëllim të mirë të mbrojtjes së mjedisit dhe ka bazë të mjaftushme faktike.

---

<sup>6</sup> INDEP, Balkan Green Foundation, *Hidrocentralet në Kosovë – Problemet dhe potenciali i tyre real*, mars 2019, faqe 18-20, i qasshëm në vegzën: <https://indep.info/wp-content/uploads/2019/03/HIDROCENTRALET-NE-KOSOVE-PROBLEMET-DHE-POTENCIALI-I-TY-RE-REAL-BGF-INDEP.pdf>.

<sup>7</sup> Po aty, faqe 24.

Mbrojtja e dekaratës së të Paditurit brenda lirisë së shprehjes gjën mbështetje edhe në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së.

30. Në rastin *Cicad kundër Zvicrës* po ashtu përmendet se «sipas praktikës gjyqësore të vendosur nga GjEDNj, diskursi për çështje të interesit të përgjithshëm nuk mund të kufizohet pa arsye bindëse.»<sup>8</sup> Përtej kësaj, ky rast nuk është i përshtatshëm për tu zbatuar në kontekstin e rastit të të Paditurit. Në rastin *Cicad kundër Zvicrës*, GjEDNj ka vlerësuar se organizatës që ka publikuar një deklaratë në interes publik, nuk i është cënuar e drejta e lirisë së shprehjes kur është detyruar nga gjykatat vendore zvicerane që ta tërheqë deklaratën me të cilën i ka cilësuar deklaratimet e një profesori universitar si Antisemite (vepër penale në bazë të Kodit Penal Zviceran). GjEDNj ka ardhë në këtë përfundim pasi që deklaratat e organizatës për profesorin nuk ishte e bazuar në fakte.<sup>9</sup> Ky vendim i GjEDNj -së nuk është i përshtatshëm për zbatim në rastin në shqyrtim pasi që, siç u dëshmuar më sipër, deklaratat e të Paditurit është e bazuar në fakte.

31. Në vendimin e GjEDNj *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*, një gazetar kishte publikuar disa artikuj lidhur me disa incidente për të cilat e kishte akuzuar Policinë për brutalitet, e madje i kishte përshkruar si bisha të egra në uniformë.<sup>10</sup> GjEDNj në këtë rast e ka konsideruar si qenësore që raportimi i gazetarit ka qenë vetëm raportim i asaj që është thënë nga të tjerët për brutalitetin policor.<sup>11</sup> Sipas GjEDNj, edhe pse i kishte akuzuar policët për vepra penale të dhunës fizike dhe sulmeve, nuk mund të kërkohet nga gazetari që t'i vërtetojë deklaratimet e veta, pasi që kjo do të paraqiste një detyrë të paarsyeshme në mos e pamundshme.<sup>12</sup> Në këtë rast GjEDNj kishte vlerësuar se gazetarit i ishte cënuar liria e shprehjes nga gjykatat vendore në Islandë pasi që deklarimeve të tij nuk i ishte dhënë mbrojtje brenda lirisë së shprehjes.<sup>13</sup>

32. Në një rast tjetër të GjEDNj-së, *G.R.A. Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus kundër Zvicrës* («GRA»), GjEDNj ka vendosur se gjykatat vendore zvicerane e kanë shkelur të drejtën e kësaj organizate në liri të shprehjes pasi që i kanë dalë në mbrojtje të reputacionit një politikani të ri i cili e kishte mbrojtur në një fjalim iniciativën për ndalimin e ndërtimit të minareve në Zvicër.<sup>14</sup>

---

<sup>8</sup> GjEDNj, *Cicad kundër Zvicrës*, paragrafi 55, i përkthyer në gjuhën gjermane «Gemäß der gefestigten Rechtsprechung des GH kann man den Diskurs über Fragen von allgemeinem Interesse nicht ohne zwingende Gründe einschränken.»

<sup>9</sup> GjEDNj, *Cicad kundër Zvicrës*, paragrafi 53.

<sup>10</sup> GjEDNj, *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*, paragrafi 65.

<sup>11</sup> Po aty.

<sup>12</sup> Po aty.

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> GjEDNj, *GRA Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus kundër Zvicrës*, Nr. 18597/13, GJEDNJ, 9 janar 2018.

Organizata G.R.A. e kishte cilësuar deklarin e politikanit si «racizëm verbal» ndërkaq, gjykatat në Zvicër kishin vlerësuar se kjo deklaratë e ka dëmtuar reputacionin e tij dhe e kishin urdhëruar organizatën ta largojë deklaratën.<sup>15</sup> GjEDNj ka vendosur se gjykatat vendore në Zvicër padrejtësisht ia kanë cënuar të lirinë e shprehjes organizatës G.R.A. dhe për këtë vendim ka marrë parasysh se përshkrimi i qëndrimeve të politikanit si «racizëm verbal», gjente mbështetje në raportimet e ndryshme të organizatave të shoqërisë civile që kishin raportuar për çështjen e iniciativës për ndalimin e ndërtimit të minareve në Zvicër.

33. Në rastin e të Paditurit, shprehja e opinionit të tij për dënimin e Paditësit nga gjykata për «gjenocid» ndaj kafshëve të egra dhe peshqve është opinion i cili ka bazë faktike nga raportime të shumta të publikuara nga organizata të shoqërisë civile, media dhe institucione shtetërore. Sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, nuk mund të kërkohej nga i Padituri që t'i vërtetojë faktet mbi të cilat e mbështetë opinionin e vet. Mjafton që opinionin të jetë bërë me qëllim të mirë dhe të jetë mbështetur në fakte. Opinioni i të Paditurit është i mbështetur në ato që janë thënë nga të tjerët, njëjtë si në rastin *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*, ku gazetari ishte mbështetur në deklaratat e të tjerëve në artikujt e tij për brutalitetin policor. Si e tillë deklarata e të Paditurit gëzon mbrojtje brenda lirisë së shprehjes si opinion.

## **B. Sa i përket pretendimeve për dëmtim të reputacionit**

34. Paditësi pretendon se postimi në Facebook i të Paditurit i ka shkaktuar dëm reputacionit të tij. Edhe po të trajtohej seriozisht pretendimi i Paditësit për dëm të reputacionit «të mirë», Paditësi nuk e ka ofruar as edhe një provë të vetme që do të mbështeste pretendimin për dëmin e supozuar të reputacionit. Për ta përshkruar dëmin e supozuar, Paditësi përdorë formulime të fryera e të ekzagjëruara duke thënë se i Padituri i paskësh shkaktuar «**dëm enorm**» dhe «**dëm jashtëzakonisht të madh**» të reputacionit. Krahas këtyre përshkrimeve, Paditësi nuk e ofron as edhe një provë të vetme që do ta dëshmonte dëmin që pretendon t'i jetë shkaktuar.

35. Në padi Paditësi deklaron: «marrë parasysh se Paditësi **gjithmonë ka pasur një emër të mirë**, ulja e reputacionit dhe statusit të respektuar në shoqëri **mund të ketë pasoja** të rënda për Paditësin – të cilat duhet domosdoshmërisht të sanksionohen». Pretendimi i Paditësit bazohet në një dëm imagjinar të së ardhmes dhe duhet të refuzohet nga Gjykata si i pabazuar. Po ashtu, sa i përket deklarin të Paditësit se Paditësi gjithmonë paskësh pasur emër të mirë, mjafton vetëm një kërkim i thjeshtë në internet që të gjinden artikujt e bashkëngjitur këtu si Prova nr.5, e që flasin për

---

<sup>15</sup> Po aty.

dëmet që i janë shkaktuar Grykës së Deçanit nga aktiviteti i Paditësit, si dhe kundërshtimin e hapur të banorëve të Deçanit dhe organizatave të shoqërisë civile ndaj ndërtimit të hidrocentraleve nga Paditësi.

36. Sa i përket kufizimit të lirisë së shprehjes për të mbrojtur reputacionin e një personi, GjEDNJ vlerëson se a i ka balancuar drejt gjykata vendore dy vlera të garantuara me Konventë: të drejtën në privatësi, e cila e përfshinë edhe mbrojtjen e reputacionit në kuadër të nenit 8 KEDNJ, dhe të drejtën e lirisë së shprehjes e cila mbrohet me nenin 10 KEDNJ.<sup>16</sup> Në raste të vlerësimit të kufizimit të lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së reputacionit, GjEDNJ e vlerëson edhe natyrën dhe ashpërsinë e sanksionit të imponuar në palën që pretendon shkeljen e të drejtës së lirisë së shprehjes kur e shqyrton se a ka qenë kufizimi i lirisë së shprehjes/ndërhyrja e shtetit proporcionale.<sup>17</sup> GjEDNJ vë reëndësi të posaçme në atë se a do të shkaktonte sanksioni një «efekt frenues» («chilling effect») ndaj lirisë së shprehjes së palës, ashtu që e dekurajon atë nga ndjekja e rasteve të kritikës së ngjashme ndaj proceseve publike.<sup>18</sup> Patjetër se çfarëdo sanksioni ose kufizimi lirisë së shprehjes së të Paditurit për deklaratën në Facebook të datës 1 nëntor 2019, do të shkaktonte efekt frenues ndaj lirisë së shprehjes së të Paditurit por, edhe ndaj të tjerëve që dëshirojnë të marrin pjesë në debat publik për mbrojtjen e ambientit. Është e qartë se kjo padi është padi SLAPP (Strategic Lawsuits Against Public Participation) – Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike. Kështu cilësohen paditë që parashtrihen nga kompani me kapital të madh, të cilat *prima facie* vërehen se janë padi të pabazuara në fakte dhe qëllimi i tyre i vetëm është që të frikësojnë dhe të dekurajojnë gazetarët apo aktivistët nga raportimi ose diskutimi i mëtejme i çështjeve me interes publik, duke i futur në procese të kushtueshme gjyqësore. Çështja e dëmeve të ambientit dhe llogaridhënia e kompanive për dëmet e shkaktuara është çështje me interes publik dhe është qenësore që debati publik lidhur me këtë çështje të mos dekurajohet me miratim të padive të tilla. Miratimi i kësaj padie do të çonte një mesazh dekurajues dhe kufizues të aktivistët tjerë që angazhohen për këto çështje dhe do të pengonte pjesëmarrjen aktive të tyre në debatin publik për mbrojtjen e ambientit.

37. Për të gjitha këto arsye, kjo padi duhet të refuzohet si e pabazuar nga Gjykata. Rikujtojmë se sipas nenit 6, paragrafi 1 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes, barra e provës i takon Paditësit, dhe jo të Paditurit për vërtetimin e përgjegjësisë për shpifje për deklarata që kanë të bëjnë me çështje të interesit publik. Me padinë për shpifje dhe dokumentet e bashkëngjitura në padi nuk

---

<sup>16</sup> *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*, Nr. 39954/08, GjEDNJ, 7 shkurt 2012, paragrafi 83, 84 dhe referencat në të.

<sup>17</sup> *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*, Nr. 39954/08, GjEDNJ, 7 shkurt 2012, paragrafi 109 dhe referencat në të.

<sup>18</sup> *GRA Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus kundër Zvicrës*, Nr. 18597/13, GjEDNJ, 9 janar 2018, paragrafet 77, 78.

është vërtetuar se i Padituri ka shpifur. Prandaj, me anë të kësaj përgjigje në padi kërkohet nga gjykata që pas shqyrtimit të padisë të nxjerrë këtë:

#### AKTGJYKIM

- I. REFUZOHET si plotësisht e pabazuar Padia për shpifje e Paditësit, KELKOS Energy Sh.P.K. kundër të Paditurit Adriatik Gacaferi e parashtruar më datë 31 janar 2020.
- II. DETYROHET Paditësi KELKOS Energy Sh.P.K. që t'ia kompensojë të Paditurit Adriatik Gacaferi, shpenzimet e avokates dhe shpenzimet procedurale.

---

Rina Kika  
Avokate  
049 355 722  
[rina@kika-associates.com](mailto:rina@kika-associates.com)

## Lista e provave dhe shtojcave

Autorizimi i Avokates Rina Kika për përfaqësim të Adriatik Gacaferit

- Prova nr.1:** Postim në Facebook në llogarinë private të të Paditurit, Adriatik Gacaferi, 4 nëntor 2020.
- Prova nr.2.1** Vendimi Ref: 04.11.2019\877-2019, i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, i datës 20 dhjetor 2019.
- Prova nr.2.2** Ankesë në KSHMK e parashtruar më 4 nëntor 2019 nga GAIA Kosova kundër RTKlive.com dhe Periskopit, për shkrimin me titull: «**Kush po dëshiron ikjen e investitorëve të huaj – Rojet e vetëshpallura të mjedisit bëhen gjithnjë e më popullore këto ditë.**»
- Prova nr.3:** Telegrafi.com, [«Komuna e Deçanit padit kompaninë austriake, shkeli ligjin me hidrocentralet»](#), 22 qershor 2016.
- Prova nr.4.** Koha.net, [«Ramosaj thotë se kompania austriake bëri shumë shkelje kur nisi ndërtimin e hidrocentraleve në Lumbardh»](#), 10 mars 2019.
- Prova nr.5**
- 5.1 Kallxo.com, [Vuajtja e Grykës së Deçanit nga hidrocentralet](#), 13 shtator 2018.
  - 5.2 Koha.net, [Katër hidrocentrale si ato që po synohen në Lumbardh kanë shkatërruar Grykën e Deçanit](#), 25 shkurt 2019.
  - 5.3 RTKlive.com, [MMPH-ja dhe shoqëria civile kundër vendimit për tri hidrocentralet në Deçan](#), 15 tetor 2019
  - 5.4 RTV21.tv, Protestuesit ‘pushtojnë’ grykën e Deçanit kundër hidrocentraleve pa leje, 13 korrik 2019
  - 5.5 Kosovalive.org, Ndërtimi i hidrocentraleve të Deçanit po e lë pa ujë shtratin e Lumëbardhit, 29 qershor 2016
  - 5.6 Klan Kosova TV, [Hidrocentrali në Deçan thanë Zonën](#), 10 prill 2016.
- Prova nr.6.1:** INDEP, Balkan Green Foundation, *Hidrocentralet në Kosovë – Problemet dhe potenciali i tyre real*, mars 2019, faqet 1-3, 18-20 dhe 24.
- Prova nr. 6.2:** Zyra e Rregullatorit për Energji, *Raport nga monitorimi i ndërmarrjes “Kelkos Energy” Sh.p.k.*, 14 dhjetor 2016, faqet 1, 17 dhe 18.